

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

**SHTOJCË**

**MBI MODIFIKIMIN DHE NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE STANDARTE TË TENDERIT**

Në bazë të ligjit Nr.162, datë 23.12.2021 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”/Me marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara/Prokurim Elektronik/Shërbim, me objekt: “*Shërbimi i mirëmbajtjes së pajisjeve të fotokopjimit, printimi dhe skanimit për vitin 2024*”, me nr. Ref-24491-10-14-2024, është paraqitur ankesë në lidhje me piken 2.3.3 të Kriteret e Vecanta te Kualifikimit të Dokumentat Standarte të Tenderit.

Në zbatim te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik Nr.1517/2024, datë 29/10/2024, Njësia e Prokurimit vendosi te kryeje modifikimet e Dokumentat Standarte te Tenderit, sipas konstatimeve dhe pranimit plotësisht te Ankeses nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, konkretisht si me poshte vijon.

**Ishte:**

**2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.3** Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar të diplomuar në një nga degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion, me kompetencat minimalisht si më poshtë:

- Staf i teknik duhet të jetë i certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve për markat e pajisjeve RICOH dhe XEROX, konkretisht 1 (një) specialist të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve Ricoh A3/A4 dhe 1 (një) specialist të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve Xerox A3/A4).
- Certifikata e trajnimit për stafin teknik duhet të jetë e lëshuar nga prodhuesi i markës RICOH dhe XEROX ose ekuivalente (në rastin e certifikatave ekuivalente këto duhet të jenë të lëshuara nga akademi/distributor të autorizuar të cilat janë të njohura nga prodhuesi i pajisjes, me kusht që të provohet e drejta legjitime për të trajnuar dhe certifikuar stafin për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt kontrate).

- Në rastin kur certifikata e trajnimit është lëshuar nga prodhuesi, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontaktet (emër, mbiemër, nr. kontakti, adresë postare, adresë e-mail) të kompanisë prodhuese për vërtetimin e autenticitetit të certifikatave nga ana e Autoritetit Kontraktor.
- Në rastin e certifikatave ekuivalente kur janë të lëshuara nga akademi/distributor të autorizuar të cilat janë të njohura nga prodhuesi i pajisjes, me kusht që të provohet e drejta legjitime për të trajnuar dhe certifikuar stafin për mirëmbajtjen e pajisjeve RICOH dhe XEROX, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontaktet e institucionit (emër, mbiemër, nr. Kontakti, adresë postare, adresë e-mail) për vërtetimin e autenticitetit të certifikatave nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Diplome përkatëse
- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B;
- Kontratë punë.

*Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.*

### **Bëhet:**

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.3** Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kompetencat minimalisht si më poshtë:

- Stafi teknik duhet të jetë i certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve për markat e pajisjeve RICOH dhe XEROX, konkretisht 1 (një) specialist të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve Ricoh A3/A4 dhe 1 (një) specialist të certifikuar për mirëmbajtjen e pajisjeve Xerox A3/A4).
- Certifikata e trajnimit për stafin teknik duhet të jetë e lëshuar nga prodhuesi i markës RICOH dhe XEROX ose ekuivalente (*në rastin e certifikatave ekuivalente këto duhet të jenë të lëshuara nga akademi/distributor të autorizuar të cilat janë të njohura nga prodhuesi i pajisjes, me kusht që të provohet e drejta legjitime për të trajnuar dhe certifikuar stafin për mirëmbajtjen e pajisjeve objekt kontrate*).
- Në rastin kur certifikata e trajnimit është lëshuar nga prodhuesi, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontaktet (emër, mbiemër, nr. kontakti, adresë postare, adresë e-mail) të kompanisë prodhuese për vërtetimin e autenticitetit të certifikatave nga ana e Autoritetit Kontraktor.

- Në rastin e certifikatave ekuivalente kur janë të lëshuara nga akademi/distributor të autorizuar të cilat janë të njohura nga prodhuesi i pajisjes, me kusht që të provohet e drejta legjitime për të trajnuar dhe certifikuar stafin për mirëmbajtjen e pajisjeve RICOH dhe XEROX, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kontaktet e institucionit (emër, mbiemër, nr. Kontakti, adresë postare, adresë e-mail) për vërtetimin e autenticitetit të certifikatave nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;
- Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, pjesa III, pika B;
- Kontratë punë.

*Kjo kerkese do te konsiderohet e permbushur gjate fazes se ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor do ti kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve të deklaruar si më lart.*